



**Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republik of Kosovo
Opština Klokot-Vrbovac/Komuna e Klokot-Vrbovcë**

Data:

Në bazë të nenit 15.1 pika c), të Ligjit për mbeturina (nr: 02/L-30), nenit 17 pika f) të Ligjit për vetëqeverisje lokale (nr: 03/L-40) dhe nenit 8 pika 1, e) të Statutit të Komunës Klokotit-Vrbovacit, Kuvendi Komunal Klokot-Vrbovcë në seancën e mbajtur më: 26.10.2011 miratoi:

**RREGULLORE NR: 05/2011
PËR ADMINISTRIMIN E MBETURINAVE**

**KREU I
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

**Neni 1
Qëllimi i rregullores**

Kjo Rregullore përcakton rregullat dhe procedurat e administrimit të mbeturinave në territorin e komunës së Klokotit-Vrbovacit, përgjegjësitet e autoritetet e komunës për administrimin e mbeturinave, kushtet nën të cilat operatorët ekonomik do të punojnë si dhe do të përcakojnë dënimë për ndotësit e mjedisit.

**Neni 2
Lënda e rregullimit**

Me anë të kësaj Rregulloreje pritet të përcaktohen kushtet për një mjeshtësi pastër, përmes sigurimit të kushteve themelore për mbrojtjen e shëndetit të qytetarëve të komunës së Klokotit-Vrbovacit.

Neni 3

Përkufizimet

Mbeturina – çfarëdo substance apo lënde që i përket kategorisë së mbeturinave të cilat pronari i hedh, ka për qëllim t'i hedh apo është i obliguar t'i hedh.

Mbeturinat komunale - mbeturinat nga amvisëritë, po ashtu edhe mbeturinat nga aktivitete të tjera, të cilat për shkak të natyrës dhe përbërjes së tyre janë të ngjashme me mbeturinat shtëpiake.

Mbeturinat komerciale - janë mbeturinat që vijnë nga objektet e përdorura kryesisht për qëllime të tregut ose biznis, sport, arsim, rekreacion, por pa përfshirë mbeturinat komunale dhe industriale.

Mbeturinat e dëmshme – janë mbeturinat me karakteristikat e mëposhtme, si:

- shpërthyese
- okside
- djegëse
- neurotike
- të dëmshme
- toksike
- kancerogjene
- korozive
- infektive
- teratogenike
- mutagenike
- që lirojnë gazra toksike në kontakt me ujin, ajrin apo acidin
- që ekziston mundësia e prodhimit të substancave të tjera të dëmshme dhe ekotoksike.

Prodhuesi i mbeturinave – është çdo person, aktiviteti i të cilit prodhon-krijon mbeturina dhe/apo kryen paraprocedurën, përzierjen/kombinimin apo aktivitete të tjera të cilat rezultojnë me ndryshimin e natyrës apo përbërjes së mbeturinave.

Poseduesi i mbeturinave – është prodhuesi i mbeturinave, përkatësisht personi juridik apo fizik, i cili i zotëron apo kontrollon ato.

Administrimi i mbeturinave - nënkupton grumbullimin, ruajtjen, rregullimin, blerjen dhe shitjen, transportimin, përpunimin, trajtimin dhe deponimin e mbeturinave, duke përfshirë edhe mbikëqyrjen e veprimeve të tillë, si dhe përkujdesjen pas mbylljes së deponisë.

Vende publike - konsiderohen: sipërfaqet e transportit publik, stacionet e autobusëve, shkollat, hapësirat përmes parkim, sipërfaqet e gjelbëruara publike (parqet, fushat, terrenet sportive, zonat përmes pushim dhe rekreacion), fushat argëtuese dhe sportive, tregjet e hapura rrëth zonës së tregut.

Operatori - është personi fizik ose juridik, i cili në përputhje me dispozitat e ligjit dhe kësaj rregulloreje, menaxhon, kontrollon ose është përgjegjës përmes objekteve dhe pajisjet përmes mbeturina, ose është i autorizuar përmes marrë vendime lidhur me funksionimin ekonomik dhe teknik të objekteve dhe pajisjeve.

Mbledhja e mbeturinave – është aktivitet sistematik i mbledhjes, klasifikimit dhe/apo përzierjes së mbeturinave, me qëllim të transportimit të tyre.

Personi – nënkupton çfarëdo personi juridik apo fizik i cili është i përfshirë drejtpërdrejtë apo tërthorazi në procesin e administrimit të mbeturinave.

Organi kompetent – është drejtoria komunale përgjegjëse përmes shërbimet publike.

Neni 4
Parimet bazë të administrimit të mbeturinave

Parimi i kujdesit dhe parandalimit – Organi përgjegjës sipas nevojës, do të hyjë në veprim për ndërmarrjen e masave parandaluese në lidhje me administrimin e mbeturinave.

Parimi – ndotësi paguan:

- personi i autorizuar i angazhuar në administrimin e mbeturinave është i detyruar të kryejë kompensimin e plotë për koston e dëmit të shkaktuar.
- në mjetet e trajtimit të prodhimit dhe deponimit të mbeturinave duhet të përfshihet kostoja e prodhimit dhe e shërbimeve.

Parimi i përgjegjësisë së prodhuesve-pronarëve – Prodhusit, shpérndarësit, shitësit, importuesit e mallrave, të cilët ndikojnë në rritjen e vëllimit të mbeturinave, janë përgjegjës për mbeturinat e krijuara si rezultat i aktiviteteve të tyre. Prodhusit kanë përgjegjësi më të madhe sepse mund të ndikojnë në kualitetin dhe ambalazhin e mallrave të tyre. Prodhesi gjithashtu është i detyruar të zgjedhë sasinë e mbeturinave nga malli i prodhuar, të zhvillojë prodhimtarinë e mallrave të recikluara dhe të krijojë treg për prodhime që mund të reciklohen dhe të përdoren përsëri. Ky princip lidhet me konceptin e “rritjes së përgjegjësisë së prodhuesve”, ku prodhesi është përgjegjës për mbeturinat të cilat janë të prodhura në secilën fazë të ciklit prodhues, e posaçërisht për mbeturinat e llojit parësor.

Parimi i mbrojtjes së të drejtave në gjykatë – Personat që janë të dëmtuar ose së paku konsiderojnë se të drejtat e tyre janë të shkelura gjatë administrimit të mbeturinave, kanë të drejtë të paraqesin padi në gjykatë, për të relaizuar të drejtat e tyre.

KREU II
ADMINISTRIMI I MBETURINAVE

Neni 5
Përgjegjësitet e Komunës

1. Përgjegjësitet e komunës janë:

- 1.1 Hartimi i marrëveshjes me kompanitë e licencuara për mbledhjen dhe transportin e mbeturinave;
- 1.2 Hartimi i planit lokal për administrimin e mbeturinave;
- 1.3 Hartimi i raportit vjetor për administrimin e mbeturinave, të cilin e dorëzojnë në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në tremujorin e parë të vitit të ardhshëm;
- 1.4 Organizimi dhe zbatimi i administrimit të mbeturinave të komunës në gjithë territorin e komunës;
- 1.5 Marrja pjesë në vendimmarrje për ndërtimin e objekteve për trajtimin e mbeturinave;
- 1.6 Sigurimi i numrit të caktuar të kontejnerëve;
- 1.7 Përcaktimi i lokacioneve për kontejnerë;
- 1.8 Dekurajimi i gjenerimit të mbeturinave nga aktivitetet e prodhimit;

- 1.9 Stilmulimi i procesit të trajtimit, për qëllim të përpunimit, reciklimit apo incerenimit të mbeturinave për fitim të energjisë;
- 1.10 Përcaktimi i afatit kohor të shërbimeve për mënjanimin e mbeturinave për qëllim të reduktimit të kohës së qëndrimit të mbeturinave në mjedisin jetësor;
- 1.11 Stimulimi i përdorimit të teknikave më të mira të mundshme për ndarjen, mbledhjen, grumbullimin, transportimin dhe deponimin;
- 1.12 Monitorimi dhe kontrollimi i administrimit të depove për mbeturinat e komunës;
- 1.13 Zgjedhja apo përcaktimi i sipërfaqes, lokacionit apo vendit publik për vendosjen e kontejnerëve për mbeturina në qendra për grumbullimin e mbeturinave.
- 1.14 Parandalimi i ndotjes së mjedisit jetësor në mjedisin urban dhe rural nga mbeturinat;

2. Për zbatimin e pikës 1 të këtij Neni është i detyruar Kryetari i Komunës dhe organi kompetent i komunës.
3. Për interesin e saj, Komuna së bashku me komunat e tjera mund të arrijnë marrëveshje për administrimin e përbashkët të mbeturinave në territoret e tyre.
4. Vendimin për bashkëpunim me komunat e tjera në pikën 2 të këtij Neni e merr Kuvendi Komunal me propozimin e Kryetarit të Komunës.

Neni 6 **Plani lokal për administrimin e mbeturinave**

1. Plani lokal për administrimin e mbeturinave hartohet me qëllim të administrimit të mbeturinave. Ky plan duhet të jetë në përputhshmëri me Planin Strategjik të Kosovës për administrimin e mbeturinave.
2. Në qoftë se dy apo më shumë komuna arrijnë marrëveshje për administrimin e mbeturinave, në bazë të Nenit 5 paragrafi 3 të kësaj rregullorej, plani nga paragrafi 1 të këtij Neni do të hartohet së bashku me komunat që janë pjesë e marrëveshjes.
3. Planet në bazë të paragrafit 1 dhe 2 të këtij Neni mund të përpunojen më së paku për një periudhë 5 vjeqare e sipas nevojës të rishikohen. Komuna harton planin lokal për administrimin e mbeturinave brenda një viti nga dita e miratimit të Planit Strategjik.
4. Përpunimi i planit në bazë të paragrafeve 1 dhe 2 të këtij Neni duhet të përmbajë:
 - 4.1 Vëllimin dhe llojin e mbeturinave të cilat pritet të krijohen, prejardhjen e mbeturinave të cilat do të përdoren apo deponohen në lokacionin e caktuar të planit të miratuar;
 - 4.2 Vëllimin dhe llojin e mbeturinave të cilat pritet të krijohen, prejardhjen e tyre e cila do të pranohet nga ana e komunave të tjera;
 - 4.3 Vëllimin dhe llojin e mbeturinave të cilat pritet të krijohen, prejardhjen e tyre e cila do t'i drejtohet komunave të tjera;
 - 4.4 Qëllimin i cili do të realizohet me përdorimin e sérishëm apo reciklimin e mbeturinave në territoret e caktuara me plan;
 - 4.5 Sasinë e mbeturinave, deponimin në zonën e caktuar me plan;
 - 4.6 Programin për grumbullimin e mbeturinave komunale shtëpiake;
 - 4.7 Programin për grumbullimin dhe kategorizimin e mbeturinave të dëmshme, përkatësisht shtëpiake;
 - 4.8 Propozimet për përdorimin e sérishëm dhe reciklimin e komponenteve të ndryshme nga mbeturinat komunale;
 - 4.9 Programin me qëllim të reduktimit të materialit, biodegradimit dhe ambalazhës në mbeturinat komunale;

- 4.10 Programin për ndërgjegjësimin publik dhe arsimin publik në lidhje me administrimin e mbeturinave;
- 4.11 Përshkrimin e lokacioneve për paisje dhe objekte duke përfshirë këtu dhe kërkesat teknike për projektimin e objekteve të reja;
- 4.12 Vlerësimin, kalkulimin e shpenzimeve dhe burimeve financiare për realizimin e aktiviteteve të planifikuara;
- 4.13 Programe të posaqme për llojet specifike të mbeturinave;
- 4.14 Masa për parandalimin apo transferin e mbeturinave të cilat nuk janë të përfshira në plan;
- 4.15 Paraqitja e mundësive për bashkëpunim mes dy apo më shumë komunave;
- 4.16 Çështje të tjera relevante.

5. Përpunimi i Planit lokal për administrimin e mbeturinave është përgjegjësi e organit përgjegjës në komunë.

Neni 7 Dispozitat për administrimin e mbeturinave komunale

1. Mbeturinat komunale, të cilat janë të përziera me mbeturinat e dëmshme duhet të veqohen nëse ekziston interes i ekonomik për to, në të kundërtën ato do të kategorizohen në grupin e mbeturinave të dëmshme.
2. Familjet janë të detyruara që mbeturinat e tyre t'i mënjanojnë në lokacionet e caktuara të cilat do t'i përcaktojnë kompanitë e licencuara të cilat merren me grumbullimin e mbeturinave, përderisa mbeturinat e dëmshme mënjanohen në lokacionet e përcaktuara posaqërisht për to.
3. Komuna është e detyruar që të organizojë grumbullimin e mbeturinave komunale, të cilat nuk mund të hidhen në kontejner (mbeturinat vëllimore).
4. Familjet dhe prodhuesit e tjerë të mbeturinave komunale janë të obliguar t'i ndajnë mbeturinat sipas llojeve me qëllim të reciklimit të tyre.
5. Komuna rregullon organizimin dhe mënyrën e ndarjes së mbeturinave që reciklohen në pajtim me Planin lokal sipas paragrafit 1 dhe 2 të Nenit 5 të kësaj Rregulloreje.

Neni 8 Zonat e shërbimit

1. Komuna brenda territorit administrativ përcakton zonat për kryerjen e shërbimit të mbledhjes, grumbullimit dhe transportit të mbeturinave.
2. Kriteret për përcaktimin e zonave sipas paragrafit 1 të këtij Neni i bën komuna dhe këto do të jenë të përmendura në planin e komunës.

Neni 9 Kontejnerët për hedhjen e mbeturinave

1. Për përcaktimin e vendit apo hapësirës për vendosjen e kontejnerit në sipërfaqet publike duhet të merret parasysh:

- 1.1. numri i banorëve;
- 1.2. numri i kontejnerëve;
- 1.3. lloji i mbeturinave;
- 1.4. lloji dhe madhësia e kontejnerëve.

Neni 10
Vendet për vendosjen e kontejnerëve

1. Vendi dhe hapësira për vendosjen e kontejnerëve për mbeturina duhet të vendoset me bazamentin e asfaltuar apo betonuar dhe të përshtatshëm për manipulimin e ngarkim/shkarkimit të mbeturinave.
2. Kontejnerët për hedhjen e mbeturinave duhet të vendosen në vende të përshtatshme dhe të dukshme ku nuk do të shkaktojë pengesë apo rrezik për lëvizjen e lirë të banorëve dhe qarkullimin e mallrave.
3. Kontejnerët duhet të jenë të ngjyrave të ndryshme ose me shenja të dukshme të cilat tregojnë për hedhje të ndarë të mbeturinave të caktuara.
4. Kontejnerët me masë deri 1.1m duhet të kenë mekanizëm për mbyllje.
5. Kontejnerët duhet të kenë sipërfaqe të butë, material që pastrohet lehtë dhe që është i qëndrueshëm dhe rezistent në ujë (metali, plastika).
6. Kontejnerët për mbeturina duhet të jenë teknikisht të përshtatshëm për automjetet që shkarkojnë dhe ngarkojnë mbeturina.

KREU III

LARGIMI I MBETURINAVE NGA SIPËRFAQET PUBLIKE DHE PRIVATE

Neni 11
Mbeturinat si objekt

1. Kjo rregullore zbatohet për:

- 1.1. Mbeturinat komunale të krijuara nga ekonomitë familjare, stacionet e trafikut, zyrat, kopshtet, vendet e argëtimi, zonat për piknik etj.;
- 1.2. Mbeturinat komerciale që krijohen prej aktiviteteve apo shërbimeve të biznesit apo komerciale;
- 1.3. Mbeturinat e krijuara nga ndërtimi, riparimi apo demolimi i objektit në masë prej 1/10 m. (nën masë 1/10 m³).;
- 1.4. Të gjitha mbeturinat me karakteristika të njëjtë me mbeturinat e përmendura nën paragrafin 1.1 dhe 1.2 të këtij Neni dhe mbledhja grumbullimi dhe transportimi i tyre mundësohet së bashku me mbeturinat e përmendura.

Neni 12
Largimi i mbeturinave

1. Largimit të mbeturinave iu nënshtrohen të gjitha sipërfaqet, publike apo private nëpër lagje, rrugë, parqe, shëtitore, terene argëtuese dhe sportive, hapësirat e banesave komerciale dhe të banimit, stacionet e trafikut dhe sipërfaqe të tjera.
2. Largmi i mbeturinave, mirëmbajtja dhe pastrimi i sipërfaqeve publike dhe private apo hapësirave sipas paragrafit 1 të këtij Neni, organizohet nga komuna.
3. Për mirëmbajtjen e pastërtisë në stacionet e trafikut, pompave të benzinës, hoteleve, kopshteve për fëmijë, ambulantave dhe spitaleve, auto kampeve, tregut të gjelbër, varrezave dhe vendeve të ngashme, janë përgjegjës personat që drejojnë këto objekte.

Neni 13

Pastrimi dhe mirëmbajtja e hapësirave publike dhe private

1. Pastrimit dhe mirëmbajtjes nga mbeturinat iu nënshtronen të gjitha sipërfaqet, publike apo private nëpër lagje, rrugët e asfaltuara, rrugët me kalldërma, qendrat, trotoaret e qytetit dhe vendet e banuara.
2. Hapësirat apo sipërfaqet publike që janë të mbuluara nga skema e pastrimit publik, drejtohen nga komuna.
3. Hapësirat apo vendet publike që nuk janë të mbuluara nga skema e drejtimit nga komuna, pastrohen dhe mirëmbahen nga institucionet apo personat që janë përdorues të këtyre hapësirave apo vendeve.
4. Hapësira private pastrohet dhe mirëmbahet nga vet pronarët ose nga kompania e autorizuar nga komuna.

Neni 14

Mbledhja, grumbullimi dhe transporti i mbeturinave

1. Të gjithë prodhuesit e mbeturinave, të përcaktuar me anë të kësaj rregulloreje, janë të detyruar të pranojnë shërbimet e personave juridik që kanë kontratë me komunën, për grumbullimin, transportin deri tek depoja.
2. Mbledhja, grumbullimi dhe transport i mbeturinave kryhet nga ana e operatorit i cili është i autorizuar/kontratuar nga komuna.
3. Operatori i autorizuar/kontratuar nga komuna duhet të posedojë automjete me pajisje të avancuara dhe teknologjinë për mënjanimin e mbeturinave, si dhe licencën për administrim të mbeturinave.

Neni 15

Transporti i i mbeturinave

1. Personi që ka licencën për grumbullimin dhe transportimin e mbeturinave, mbledh mbeturinat nga prodhuesit dhe/apo pronarët dhe i transporton ato deri te objekti, përkatësisht vendi për asministrim të mbeturinave.
2. Mbeturinat e rrezikshme mblidhen dhe transportohen në mënyrë të veçantë.
3. Transporti i mbeturinave kryhet me anë të pajisjeve të përshtatshme dhe në mënyrë të përshtatshme, që të mos vijë deri tek shpërndarja e tyre, zgjërimi, në përputhje me rregullat dhe procedurat në fuqi.
4. Nëse vjen deri tek ndotja gjatë transportimit të mbeturinave, transportuesi është i detyruar ta kthejë vendin e ndotur në gjendjen e mëparshme.
5. Në qoftë se mbeturinat e transportuara nuk pranohen në vendin e synuar, transportuesi duhet t'i kthejë në vendin e mëparshëm.

Neni 16

Rastet e jashtëzakonshme

Me rastin e rasteve të jashtëzakonshme, fatkeqësive natyrore, ndodhive shoqërore (termetet, ciklonet, rrufetë, eksplodimet, vulkanet, luftërat, lëvizjet, aktet terroriste apo ushtarake) që i pengojnë operatorit të kryejë obligimet e tij sipas licencës dhe marrëveshjes për largimin e mbeturinave, organet përgjegjës i komunës, në bashkëpunim me MMPH dhe Ministrinë e

Shëndetësisë dhe institucioneve të tjera relevante, nxjerrin urdhër për masa të posaqme të cilat duhet të zbatohen me rastin e rasteve të jashtëzakonshme.

Neni 17
Ndalimet dhe kufizimet

1. Në bazë të dispozitave të kësaj Rregulloreje ndalohet:

- 1.1 Hedhja e mbeturinave ndërtimore në rrugë, trotoare, qendra të banuara apo mjetë publike;
 - 1.2 Hedhja e mbeturinave dhe llojeve të tjera në kontejner apo pika për grumbullimin e mbeturinave komunale që nuk klasifikohen si mbeturina komunale;
 - 1.3 Hedhja e mbeturinave në mjetësin e përbashkët brenda dhe jashtë objekteve për banim (ballkoneve, korridoreve, terrasave, banesave etj);
 - 1.4 Hedhja e mbeturinave komunale në rrugë, trotoare, qendra të banuara apo sipërfaqe të tjera publike;
 - 1.5 Përzierja dhe hedhja e mbeturinave jashtë kontejnerëve të cilët janë të destinuar për lloje të caktuara të mbeturinave (metal, xham, letra);
 - 1.6 Hedhja e mbeturinave prej automjeteve gjatë lëvizjes;
 - 1.7 Ndalohet hedhja dhe deponimi i mbeturinave në sipërfaqe publike (në rrugë, parqe dhe vende të tjera publike);
 - 1.8 Ndërrimi i vendeve të kontejnerëve, pikave apo vendeve të betonuara për hedhjen e mbeturinave pa autorizim nga ana e autoriteteve të komunës;
 - 1.9. Djegia e mbeturinave në vende publike, kontejner apo në pika për grumbullimin e mbeturinave;
 - 1.10. Përdorimi i mbeturinave si ushqim për kafshë apo ngjashëm prej kontejnerëve apo pikave të grumbullimit;
 - I.I Përdorimi i kontejnerëve publik për biznese ekonomike për llojet e mbeturinave që nuk përfshihen në përkufizimin "mbeturina komunale dhe komerciale";
 - 1.12. Gërmimi, përzierja, derdhja dhe shpërndarja e mbeturinave të hedhura në kontejner apo në pika për grumbullimin e tyre nga persona jo të autorizuar;
 - 1.13. Hedhja e mbeturinave jashtë kontejnerit për mbeturina;
 - 1.14. Derdhja e mbeturinave apo rrjedhja prej automjeteve gjatë kohës së udhëtimit deri tek impianti për trajtimin apo deponimin për mbeturina;
 - 1.15. Njerëzit duhet të ndërmarrin masa, që gjatë kohës së transportit të mbeturinave, automjetet e tyre të kenë mbulesë të përshtatshme me qëllim të parandalimit të derdhjes, shpërndarjes apo rrjedhjes së mbeturinave gjatë kohës së transportit të bimëve apo trajtimit apo në deponitë për mbeturina;
 - 1.16. Ndërrimi i mënyrës, metodës, teknikës dhe teknologjisë së mënjanimit të mbeturinave në kundërshtim me kushtet e përcaktuara me kontratë apo në formë tjetër.
2. Secili ndryshim i kushteve nga neni 1 nënparagrafi 1.8 i këtij Neni duhet të miratohet me shkrim nga organet përgjegjëse të komunës, duke pasur parasysh kushtet tekniko-higjenike të mjetësor.

KREU IV
INSPEKCIIONI

Neni 18
Mbikqyrja inspektive

Inspektimin në çështjet e aktiviteteve për administrimin e mbeturinave i kryen shërbimi përgjegjëst i Inspektoriatit Komunal.

Neni 19
Obligimet e inspektorit

1. Obligimet e inspektorit janë:

- 1.1 Të kontrollojë krijimin, grumbullimin, prodhimin, ruajtjen, trajtimin dhe deponimin e mbeturinave;
- 1.2 Të kontrollojë transportin dhe tregtimin e mbeturinave të dëmshme brenda procesit të administrimit të mbeturinave;
- 1.3 Të verifikojë administrimin e mbeturinave nga ana e pronarit të mbeturinave;
- 1.4 Të kontrollojë dhe konstatojë realizimin e planeve në lidhje me administrimin e mbeturinave;
- 1.5 Të kontrollojë mënyrën e mbajtjes dhe ruajtjes së të dhënave për administrimin e mbeturinave;
- 1.6 Të kontrollojë procedurat gjatë transportit të mbeturinave brenda kufijve të Komunës, gjatë hyrjes, daljes dhe tranzitit;
- 1.7 Të kontrollojë zbatimin e dispozitave të kësaj Rregulloreje dhe akteve të tjera të lëshuara në bazë të saj;
- 1.8 Të hartojë raportin për realizimin e punëve të inspektimit dhe propozojë masat e nevojshme për administrimit e mbeturinave;
- 1.9 Të konstatojë përm bushjen e kushteve të punës nga operatori në përputhje me kërkesat e specifikuara nga licenca për administrimit e mbeturinave.

Neni 20
Përgjegjësitë e inspektorit

1. Përgjegjësitë e inspektorit janë:

- 1.1 Të urdhërojë realizimin e planit për administrimin e mbeturinave;
- 1.2 Të urdhërojë prodhuesin apo pronarin e mbeturinave për mbajtjen e evidencës dhe ruajtjen e të dhënave mbi mbeturinat;
- 1.3 Të urdhërojë prodhuesin apo pronarin e mbeturinave t'ia dorëzojë ato vetëm personave fizik apo juridik të autorizuar me licencë për administrimin e mbeturinave;
- 1.4 Të urdhërojë personat e licencuar për administrimin e mbeturinave që mbeturinat t'i grumbullojnë dhe transportojnë ndaras sipas llojeve të tyre;
- 1.5 Të ndalojë pranimin, trajtimin dhe deponimin e mbeturinave në kundërshtim me kushtet e specifikuara në licencë;
- 1.6 Të ndalojë ndërtimin e objekteve dhe impijanteve, objekteve instaluese për administrimin e mbeturinave të cilat nuk i përbushin kushtet teknike dhe kërkesat e tjera që dalin nga Ligji dhe aktet tjera normative;
- 1.7 Të ndalojë transportin e mbeturinave të dëmshme në qoftë se transporteri nuk ka licencë dhe dokumentacion të kompletuar;
- 1.8 Të ndalojë deponimin e mbeturinave në lokacionet teknikisht të papërgatitura për ruajtjen e përkohshme të tyre dhe nëse pronari nuk posedon licencë apo i ka skaduar afati i licencës së tij;

- 1.9 Të ndalojë përdorimin e objektit, instalimin, përdorimin e aparaturave dhe pajisjeve për të cilat nuk ka licencë;
- 1.10 Të ndalojë përdorimin e pajisjeve mobile për trajtimin e mbeturinave pa posedimin e lejes për përdorimin e lokacionit;
- 1.11 Të ndalojë përzierjen e mbeturinave komunale me mbeturinat e dëmshme;
- 1.12 Të ndalojë pranimin e mbeturinave të rrezikshme në depot e mbeturinave komunale;
- 1.13 Të ndalojë përzierjen e mbeturinave të shumëllojshme të rrezikshme;
- 1.14 Të ndalojë hyrjen, daljen dhe tranzitin e krijuar në kundërshtim me dispozitat e kësaj Rregullorje.**

**KREU V
DËNIMET DHE GJOBAT**

**Neni 21
Dispozitat penale**

Organi i komunës gjatë mbikqyrjes së dispozitave të kësaj Rregulloreje konstaton se personi fizik apo juridik ka shkelur dispozitat e kësaj Rregulloreje dhe i vendos gjobë mandatore.

Neni 22

Personit fizik apo juridik i cili ka shkelur dispozitat e kësaj Rregulloreje shqiptimi i ndëshkimit me gjobë mandatore i bëhet në vend të ngjarjes.

Neni 23

Organi përgjegjes i cili e bën shqiptimin e gjobës mandatore personit fizik apo juridik duhet t'i japid urdhëresën e dënimit mandator të paguar.

Neni 24

Organi përgjegjës gjatë shqiptimit të gjobës mandatore bënë identifikimin personit fizik apo juridik të cilat i shqiptohet gjoba dhe nga i njëjtë merr të dhënat nga dokumentet e identifikimit.

Neni 25

Nëse personi fizik apo juridik nuk ka me vete dokument identifikues apo refuzon të jap të dhëna personale, organi përgjegjës do të kërkojë mbështetje nga Shërbimi Policor i Republikës së Kosovës dhe personi i njëjtë do të dërgohet në Shërbimin Policor të Republikës së Kosovës për identifikim.

Neni 26

Urdhëresa që i jepet personit fizik apo juridik për pagesën e gjobës nga organi përgjegjës duhet të përmbytë: emrin, mbiemrin, numrin e letërnjoftimit të personit të dënuar, vlera e dënimit, koha dhe vendi i shqiptimit të gjobës, numri i llogarisë ku duhet të bëhet pagesa, emri dhe mbiemri i personit që ka vendosur dënimin, numri i tij i letërnjoftimit dhe numri i organit përgjegjës.

Neni 27

1. Forma e faturës nga Neni 26 i kësaj Rregulloreje është e dhënë në shtojcën I të kësaj Rregulloreje dhe është pjesë përbërëse e saj.
2. Urdhëresa duhet të jipet në katër (4) kopje, një kopje i jipet personit që dënohet, një organit përgjegjës i cili e shqipton gjobën, një kopje i dorëzohet Gjykatës për shkelje dhe një mbetet në arxivë.

Neni 28

Personi fizik apo juridik të cilil i shqiptohet gjoba është i obliguar të kryej pagesën në afat prej shtatë (7) ditësh prej ditës së dënitit.

Neni 29

Personi fizik apo juridik duhet të kryej pagesën në Buxhetin e Republikës së Kosovës në llogarinë sipas Nenit 26 të kësaj Rregulloreje, për të cilën merr vërtetimin.

Neni 30

Personi fizik apo juridik i cili është i ndëshkuar me gjobë mandatore duhet t'ia sjellë dëshminë e pagesës organit i cili e ka shqiptuar gjobën më së largu 7 ditë pas shqiptimit të gjobës.

Neni 31

Nëse personi fizik apo juridik nuk i sjell dëshmi për pagesën e kryer organit përgjegjës brenda këtij afati, atëherë organi përgjegjës e dërgon lëndën e procedon në Gjykatën përkatëse për kundërvajtje.

Neni 32

Organet përgjegjëse, në rast nevoje, detyrohen të bashkëpunojë mes vete për zbatimin e dispozitave të kësaj Rregulloreje.

Neni 33

Veprimtaritë ndëshkuese me gjobë mandatore dhe gjoba e dënitit për person

1. Me gjobë prej prej 5 Euro shqiptohet dënimis personit nëse:
 - I. I hedhë cigare në rrugë apo sipërfaqe publike,
 - 1.2 hedhë çamçakëz në rrugë apo sipërfaqe publike.
2. Me gjobë prej prej 10 Euro shqiptohet dënimis personit nëse:
 - 2.1 hedhë mbeturina prej letre në rrugë apo sipërfaqe publike,
 - 2.2 hedhë mbeturina prej plastike në rrugë apo sipërfaqe publike,
 - 2.3 hedhë ambalazha prej xhami në rrugë apo sipërfaqe publike,
 - 2.4 hedhë kanaqe në rrugë apo sipërfaqe të tjera,
 - 2.5 hedhë mbeturina ushqimore në rrugë apo sipërfaqe publike,
 - 2.6 pa dashje hedh çfarëdo lloji të mbeturinave në rrugë apo sipërfaqe publike.

3. Me gjobë prej prej 20 Euro shqiptohet dënim i personit nëse:

- 3.1.hedhë mbeturina komunale jashtë kontejnerit për mbeturina komunale,
- 3.2. gërmor nëpër kontejner për mbeturina, merr apo shkatërron-hedh mbeturina nga kontejneri,
- 3.3. hedhë mbeturina të përziera në kontejner ku mbeturinat janë të klasifikuara si: organike, xhami, letra, plastika, metali, etj.
- 3.4.mbeturinat nga druri i prerë i lë në rrugë apo sipërfaqe publike;
- 3.5 mbeturinat nga qymyri i lë në rrugë apo sipërfaqe publike,
- 3.6. nuk pastron pas kafshëve të tyre në rrugët e trotoarit, objektet e banimit kolektiv dhe sipërfaqe të tjera publike.

4. Me gjobë prej prej 30 Euro shqiptohet dënim i personit nëse:

- 4.1.hedhë cigare në rrugë apo nga automjeti në lëvizje
- 4.2.hedhë ambalazhin dhe mbeturinat prej letre në rrugë apo nga automjeti në lëvizje,
- 4.3. hedhë ambalazhin dhe mbeturinat prej plastike në rrugë apo nga automjeti në lëvizje,
- 4.4. hedhë ambalazhin dhe mbeturinat prej xhami në rrugë apo nga automjeti në lëvizje.
- 4.5.hedhë kanaqet në rrugë apo nga automjeti në lëvizje,
- 4.6.hedhë mbeturina ushqimore në rrugë apo nga automjeti në lëvizje,
- 4.7.shkatërron kontejnerët për mbeturina komunale
- 4.8.ndërron vendin e kontejnerit për mbeturina komunale,
- 4.9.hedhë akumulator në kontejnerin për mbeturina komunale,
- 4.10.hedhë pajisje elektrike dhe elektronike në kontejner për mbeturina komunale.
- 4.11.hedhë mbeturina prej automjeteve të vjetra në kontejner për mbeturina komunale, në rrugë, në natyrë apo në sipërfaqe publike,
- 4.12. hedhë ambalazha dhe mbeturina prej letre në natyrë.
- 4.13. hedhë ambalazha dhe mbeturina prej plastike në natyrë,
- 4.14. hedhë ambalazha dhe mbeturina prej xhami në natyrë.
- 4.15. hedhë kanaqe në natyrë,
- 4.16. hedhë mbeturina ushqimore në natyrë.
- 4.17. hedhë mbeturina nga kopshti në kontejner për mbeturina komunale.

5. Me gjobë prej prej 50 Euro shqiptohet dënim i personit nëse:

- 5.1.hedhë çfarëdo lloji të mbeturinave nga ballkoni apo dritarja e objektit.
- 5.2.hedhë mbeturina në pusetat e kanalizimit,
- 5.3.hedhë mbeturinat nga ambalazhet e materialit ndërtimor jashtë kontejnerit (ambalazha prej letre, metali, plastika apo materiale të tjera).
- 5.4.hedhë mbeturina prej ngjyre në kanalizim.
- 5.5. hedhë mbeturina prej ngjyre në kontejner për mbeturina komunale,
- 5.6.hedhë mbeturina të vajit në tokë nga moskujdesi,
- 5.7. hedhë mbeturina medicinale në kontejner për mbeturina komunale,
- 5.8.hedhë mbeturina në afërsi të rrugës afër vendbanimeve (nuk nënkupton shkatërrimin e mbeturinave nëpër livadhe),
- 5.9.hedhë mbeturina në pronën e huaj,
- 5.10.hedhë pajisjet elektrike dhe elektronike në sipërfaqe publike apo në natyrë,
- 5.11.hedhë bateri apo akumulator në sipërfaqe publike apo në natyrë,
- 5.12.hedhë cigaren e ndezur në kontejner për mbeturina komunale.
- 5.13.hedhë hir të nxeh të në kontejner për mbeturina komunale.

6. Me gjobë prej prej 70 Euro shqiptohet dënim i personit nëse:

- 6.1.hedhë mbeturina nga materiali ndërtimor jashtë vendit apo kontejnerit i cili është i përcaktuar nga ana e organit komunal për mbeturina të materialit ndërtimor,
 - 6.2. hedhë mbeturina nga materiali ndërtimor në kontejnerin për mbeturinat komunale,
 - 6.3 hedhë mbeturina medicinale në hapësirën publike apo në natyrë,
 - 6.4. hedhë mbeturina medicinale jashtë kontejnerit për këtë lloj të mbeturinave,
 - 6.5.hedhë mbeturina në sasi të madhe në kontejner apo te mbeturinat komunale, hapësirë publike apo në natyrë.
 - 6.6 hedhë lloje të tjera të mbeturinave në hapësirë publike apo në natyrë,
 - 6.7.hedhë mbeturina të përziera me vaj në kontejnerin për mbeturina komunale,
 - 6.8. mbeturinat prej druri nga prerja e bimëve apo drunjëve nuk i mbledh nga rruga apo hapësira publike në kohën e prerjeve,
 - 6.9.hedhë mbeturina prej druri nga prerja e bimëve apo drunjëve në kontejnerët për mbeturinat komunale.
- 6.10. djegë mbeturinat komunale në kontejner.

7. Me gjobë prej prej 100 Euro shqiptohet dënim i personit nëse:

- 7.1. hedh çfarëdo mbeturine në rrëketë e ujit, lumi, liqenit apo sipërfaqeve të tjera me ujë,
- 7.2. hedh çfarëdo mbeturine në bregun e rrëkeve, lumi, liqenit apo sipërfaqeve të tjera me ujë.
- 7.3. hedh mbeturina të vajit në hapësira publike, kanalizim, rrugë apo natyrë,
- 7.4. hedh mbeturina të përziera me vaj në hapësira publike apo natyrë,
- 7.5. hedh mbeturina prej gome apo goma të automjeteve në hapësira publike apo natyrë,
- 7.6. djegë mbeturinat komunale në hapësira publike apo në natyrë,
- 7.7. djegë goma, goma të automjeteve apo mbeturina të tjera prej gome, në hapësira private, publike, rrugë apo natyrë.
- 7.8. djegë mbeturina të ndryshme prej plastike, në hapësira private, publike apo në natyrë,
- 7.9. djegë mbeturina të ndryshme prej letre në hapësira private, publike apo në natyrë,
- 7.10. djegë vajëra, mbeturina nga vaji në hapësira private, publike apo në natyrë,
- 7.11. derdhë çfarëdo substance në sipërfaqe private, publike, në natyrë, dhe me atë rast krijon mbeturina nga ajo.

Neni 35 **Dënimet mandator**

1. Veprimtaritë e ndëshkuese me gjobë mandatore dhe vlera e dënitit mandator janë të specifikuara në Nenin 34, të kësaj Rregulloreje.
2. Organi përgjegjës shqipton gjobat mandatore sipas specifikave të Nenit 34 të kësaj Rregulloreje.

Neni 35

1. Në bazë të veprimtarisë ndëshkuese mandatare, vendoset edhe vlera e dënitit monetar mandatar - Euro.
2. Lartësia e dënitit mandatar do të jetë nga 5 deri 100 €, në varësi nga veprimit ndëshkues me gjobë mandatore.

Neni 37 **Ankesa**

1. Personi i cili është ndëshkaur me gjobë ka të drejtë ankesë pas kryerjes së pagesës.
2. Personi paraqet ankesën në afat prej 15 ditësh pas shqiptimit të gjobës.
3. Nëse Gjykata vërteton se personi i ndëshkuar nuk është fajtor, personit i kthehen mjetet e paguara.

Neni 38
Raportimi

1. Organi përgjegjës i cili shqipton ndëshkimin me gjobë mandatore sipas dispozitave të kësaj Rregulloreje detyrohen ta raportojnë MMPH mbi numrin, veprimin e ndëshkimeve me gjobë mandatore dhe vlerën e tyre në të holla.
2. Raporti bëhet për vitin e kaluar, deri më 31 mars të vitit të ardhshëm.
3. Forma për raportim është në shtojcën I formulari 2.

KREU XI
DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 39
Zbatimi i Rregullores

Për zbatimin e Rregullores është kompetente drejtoria komunale përgjegjëse për shërbimet publike, inspektoriati i komunës dhe policia.

Neni 40

Kjo Rregullore hyn në fuqi në ditën e miratimit në Kuvendin Komunal Kllokotit-Vërbovcit.

KUVENDI KOMUNAL KLLOKOT-VËRBOVC
Nr: 05/2011 me 26.10.2011

Data: 26.10.2011
në Kllokot-Vërbovc





KOMUNA KLLOKOT-VËRBOVC

Shtoja I Formulari 1

Nr. serik 0001

Në bazë të Nenit 51 Ligjt për mbeturina me Nr. 02/L-30, udhëzimit administrativ të MMMPH-së për ndëshkimet me gjobë, si dhe Regullorës së Komunës së Kllokot-Vërbovcit, për Administrimin e Mbeturinave, nxjeret:

Urdhëresë për pagesë për ndëshkimet me gjobë mandatore

I. Informata të përgjithshme për shkelje që është bërë ndëshkimi me gjobë mandatore:
dita 20 koha: 20 Në: _____ Vendi i dënimit (Vendi, Komuna)

Regullorja e Komunës së Kllokot-Vërbocit: Ndëshkimet me gjobë mandatore-Neni: _____ Paragraft: _____ Dënimini: (Euro) _____
2. Të dhënët për personit që ndëshkohet me gjobë mandatore
Emri dhe mbiemri: _____ Vend i lindjes: _____
Adresa: _____ Nr. tel: _____ Vend i punës: _____
Numri i letërmjftimit: _____ Vendi i lëshimit: _____
Nënhkrimi i personit të dënuar: _____

3. Reporti i organit përgjegjës

Përshtrimi i aktivitetit të dënuar me dënim mandatar:

4. Të dhënët e organit të autorizuar i cili ndëshkon me dënim monetar mandatar:

Emri dhe mbiemri i organit të autorizuar: _____ Numri i identifikimit të zyrtarit: _____

Institucioni që shqipton ndëshkimin _____ - vendi _____ Njësia _____ Nënskrimi _____

5. Vërejtje:

Nëse dënnimi nuk paguhet në afatin prej shtatë (7) ditësh, dokumentet mbështetëse do të rëzohen në gjykatë për procedurë të mëtejshme .
Personi fizik apo juridik mund ta pagauj dënimin brenda 7 ditësh, në cilëndo bankë të Kosovës ku paratë mund të transferohen në BPK, në llogarinë e caktuar:



KOMUNA KLOKKOT-VĚRBOVČ

Formulari 2. Formulari për raportin e organit përgjegjës në MMFPH